



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së pestë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 03.12.2020, e cila filloi në orën 13:30.**

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit: Mehreme Llumnica, Ramadan Salihu, Jeton Canhasi dhe Gyltene Retkoceri.

Munguan: Ermira Shabani dhe Armend Ademi.

E pranishme ishte edhe Prentima Preniqi, koordinatore e Njësisë për të drejtat e njeriut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese.

**Kryesuesja konstatoi se u miratua ky**

**REND I DITËS:**

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;
2. Raporti mbi monitorimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, 2018 - 2020;
3. Gjendja si pasojë e COVID-19 - testimi për PAK;
4. Të ndryshme.

**Pika e parë**

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së katërt të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

**Pika e dytë**

**Raporti mbi monitorimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, 2018 - 2020.**

**Faqe 1 nga 8**

**Mehreme Llumnica** u shpreh e pajtimit me paraqitjet e raportit, në veçanti pikës kushtuar punësimit të PAK. Ajo theksoi se duhet marrë masa për monitorimin e gjendjes aktuale, sepse jemi të diskriminuar dhe të pa trajnuar në këtë aspekt.

**Gyltene Retkoceri** theksoi se në këtë raport janë 37 pika, kjo që e ceku Mehremja është e para dhe hyn në kuadër të Planit të veprimit.

**Mehreme Llumnica** bëri të ditur se në Kuvendin e Komunës janë zotuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, por nuk ka asnë lëvizje në këtë drejtim. Përveç Ndërmarrjes Publike Banesore, e cila ka punësuar 3-4 persona të shurdhër prej listës që kemi përcjellë te z. Muhedini. Anëtarët e KKPAK-së kanë aplikuar në Komunën e Prishtinës, por nuk janë përfillur. Janë zotuar që do të bëhet e mundur rritja e numrit të të punësuarve nga kjo kategori, së paku me një përqindje, dhe janë zotuar se do ta zbatojnë ligjin, por nuk është bërë asnë lëvizje në këtë drejtim.

**Mehreme Llumnica** propozoi që kompania "Prishtina Parking" të punësojë 1, eventualisht 2 persona nga PAK, pasi është e rregulluar edhe me Udhëzimin administrativ. Është me rëndësi, sepse kjo kompani që tashmë është si ndërmarrje, ka filluar ndërtimin e parkingjeve, duhet marrë hapa konkretë që të identifikohen parkingjet ku mund të kemi pjesëtarë nga Hendikosi, por procedura po shkon shumë ngadalë.

**Premtime Preniqi** bëri të ditur se edhe ajo është interesuar lidhur me çështjen e parkingjeve për pjestarët e PAK.

**Jeton Canhasi** theksoi se kur jemi këtu te parkingjet, kompania jonë është mbikëqyrëse, ne e kemi monitorimin, dhe unë si projektues, si mbikëqyrës do t'ju informoj sa vende janë për PAK, se projekti është bërë dhe do të realizohet, andaj ne nuk mundemi tanë me ndërrhyrë, por projektuesi e ka pasur obligim, mirëpo nëse ka bërë ndëshkime, unë do t'ju lajmëroj dhe ju me një shkresë me kërkuar me u bërë ndryshime, mirëpo unë besoj se janë parë parkingjet, përndryshe Urbanizmi nuk ia kishte dhënë lejen pa i pasur kushtet.

**Fatime Demolli - Mustafa** tha se do të ishte mirë që të kishim mundësi për ta parë projektin.

**Jeton Canhasi** shprehu mendimin se me parë projektin nuk kemi nevojë, por me iu prezantuar se çka është paraparë për PAK.

**Ramadan Salihu** theksoi se të gjitha këto që po i cekni janë në monitorim. Pas miratimit të Planit të veprimit, Kuvendi na ka obliguar si Komitet me e monitoruar zbatimin e Planit të veprimit, dhe aty parashihet parkingu, mirëpo monitorimi se çka është bërë, çka mund të bëhet përfundon në 31 dhjetor dhe çështja e tij mbyllët. Kam insistuar me u bërë kjo, në qoftë se eventualisht mbahet një Asamble komunale për PAK, që u kushtohet atyre me u prezantuar, sepse niveli qendorr veç po mban një seancë, pse Asambleja mos ta mbajë.

**Mehreme Llumnica** tha se është për falënderim, është iniciativa e mirë e Kuvendit, e kanë mbajtur sikur të mos ishte deputet vetë Feta Rudi, përdorues i karrocës, dhe sikur mos të kishin lobuar që janë ngjitur shkallëve disa herë, tash as platforma nuk ishte bërë në Kuvendin e Kosovës. Sot e kanë promovuar platformën me hyrë dhe aty doli edhe një rezolutë, do me thënë Ramadan mirë e ke cekur monitorimin, se është dashur me marrë më herët këtë hap, se vetëm ne kur jemi merret diçka për neve, nëse ne nuk jemi përfaqësues ose nuk jemi prezent, atëherë nuk del asgjë.

**Ramadan Salihu** theksoi se është dashur të përgatitet dokumenti përfundimtar dhe t'u dërgohet kompetentëve, dhe me iu thënë se na keni premtuar se këto do të realizohen, këtu janë kryer rrith 30% dhe këto tjerat nuk janë kryer.

**Mehreme Llumnica** tha se po të kishim mundur ta iniciacionim një takim më herët dhe nëse ishte mbajtur ndonjë seancë, ku ne do të dilnim me një pasqyrë të qartë se çka është realizuar dhe çka nuk është realizuar, por tash ndoshta është vonë.

**Ramadan Salihu** theksoi se nuk është vonë edhe në janar, kurdo që të mbahet në prag të skadimit të këtij Plani të veprimit, le të na ftojnë kurdo, vetëm mos të na ftojnë formalisht.

**Fatime Demolli - Mustafa** informoi lidhur me këtë pikë, duke thënë se e ka kontaktuar një asamblist i Kuvendit për të ditur se çka po ndodh sot me Komitetin e PAK për 3 dhjetor, dhe a mundet të marrë pjesë në takim, meqenëse është kohë e shkurtër me organizuar diçka të tillë, ka mbetur me na ftuar neve si Komitet në mbledhjen e rregullt të Kuvendit, në mënyrë që ta shpalosim raportin mbi monitorimin e Planit të veprimit dhe të shohim tutje çka mund të na ndihmojnë asamblistët.

Po ashtu, pyeti se a kanë ndonjë ndryshim apo plotësime lidhur me raportin mbi monitorimin e Planit të veprimit për PAK në komunën e Prishtinës, 2018 - 2020.

**Ramadan Salihu** u shpreh se opinionet tona, vërejtjet tona, kërkesat tona në detale i kemi paraqitur në raportin e monitorimit në vitin paraprak, ku kemi thënë se punësimi nuk po zbatohet, për këtë arsy është dashur me u prezantuar, ky tani është vetëm çka ka ndryshuar prej atij rapporti deri në kohën e këtij që e kemi sot, që edhe po përmbyllët epoka e tij, me pa se çka ka kërkuar Plani, ku është zbatuar në fazën e parë dhe ku jemi tash në fazën e dytë dhe të fundit.

**Mehreme Llumnica** shprehu mendimin se te monitorimi duhet përmendur se Drejtoria e Mirëqenies Sociale konform Planit të veprimit, që kemi kërkuar si OJQ, objektet e organizatave që marrin shërbime PAK i kanë rinouar shumicën, disave edhe iu kanë paguar qiranë dhe i ka marrëveshjet çka janë ndërmarrë. Në komisionin për subvencione kemi kërkuar që të jetë një anëtar i OJQ-së që merret me personat me aftësi të kufizuara, edhe atë e ka realizuar Drejtoria e Mirëqenies Sociale, ka ndarë subvencione dhe në kohën e pandemisë ka sjellë pako ushqimore për PAK, ka kërkuar lista, ka ndarë edhe projekte, ku herën e fundit i ka qitur në Asamble komunale pa konkurse, pa grand, në mënyrë lineare janë votuar prej asamblistëve projektet për OJQ-të që i kanë pasur vitin e kaluar në atë shumë, kështu që ne vetëm duhet me lobuar.

**Premtime Preniqi** tha se kur është fjala për parkingjet, kur jeni në ndonjë grup dhe shqyrtohet çështja e PAK, automatikisht duhet jo vetëm ju, por të gjithë duhet reaguar në grup apo individualisht, me ngritur zërin, e në këtë rast kur je pjesë e saj, mos me lejuar me vazhduar procesi pa u rregulluar çështja e parkingut për PAK, se kjo nuk është që po shprehet dëshira jote, por po zbatohet një ligj që është në fuqi.

**Jeton Canhasi** u interesua të dijë se a kanë planifikuar tualete për PAK në parkingje ku janë 700 makina, ku edhe për këtë çështje do ta vërtetoj.

**Premtime Preniqi** u përgjigj se nuk ka njohuri për këtë çështje.

**Mehreme Llumnica** theksoi se te parkingjet desha të shtoj se janë bërë shumë pjerrina në Sheshin e Prishtinës, më mirë është që ajo të bëhet në vendin e caktuar dhe të jetë e shfrytëzueshme dhe jo me bërë shumë e të pashfrytëzueshme.

**Gyltene Retkoceri** shprehu kënaqësinë që kolegu qenka mbikëqyrës për parkingjet dhe secili prej nesh si anëtar i Komitetit, jemi me profesione të ndryshme dhe secili prej nesh me pasur parasysh fushën tonë profesionale, kështu që t'i si pjesë e Komitetit nuk duhet lejuar gabime, sepse sipas Planit të veprimit e kemi çështjen e parkingjeve për PAK.

**Ramadan Salihu** tha se më 3 dhjetor është Ditën Ndërkombëtare e PAK dhe ne vijmë prej komunitetit, mirëpo gjatë punës tonë nuk shihet gjëkund lidhja me komunitet, ne vetëm i japim mendimet, kështu që do të duhej që shoqatat, si "Hendikos", Shoqata e të Verbërve, Shoqata e të Shurdhërvë etj., të bashkëpunojnë edhe me ne. Në adresën tonë elektronike asnijëherë nuk kemi asnijë njoftim, kërkesë prej komuniteteve.

**Mehreme Llumnica** bëri të ditur se është në rrjedhë të plotë me "Hendikos", bashkëpunon vazhdimisht, dhe në konkurse na kanë zgjedhur, sepse e kemi një urë lidhëse me OJQ-të që merren me aftësitë e kufizuara.

**Fatime Demolli - Mustafa** ceku dy çështje për diskutim lidhur me raportin e Planit të veprimit, është pika 20, ku thuhet: "Gjuha e shenjave në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës nuk ekziston, por mbetet në perspektivë", kështu që kjo pikë duhet të rregullohet. Pika 25, ku thuhet: "Sigurimi i transportit të fëmijëve me nevoja të veçanta për shkollim të mesëm të lartë, bëhet vetëm në shkollim special". Edhe kjo pikë duhet të rregullohet, sepse transporti për fëmijët me nevoja të veçanta bëhet në komunën e Prishtinës për të gjithë fëmijët që janë me nevoja të veçanta, jo vetëm për fëmijët që janë në qendra burimore.

Kemi "Rekrutimi i asistentëve të fëmijëve me nevoja të veçanta", te pika 24 thuhet: "Sigurimi i mësimdhënësit mbështetës", kjo është rekrutuar deri në një masë", asistenti i fëmijëve me nevoja të veçanta, pra është rekrutuar një pjesë e tyre.

Po ashtu, "Sigurimi i mësimdhënësit mbështetës (asistentit të klasës)", instruktorit të Gjuhës së shenjave për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim, që do të duhej të ishin këtu tri nënpiaka.

**Ramadan Salihu** theksoi se e ka dëgjuar në televizor, se ky rekrutim është bërë më 4 muaj dhe bartës ka qenë Forumi i aftësive të kufizuara. Kjo është krejtësisht e papranueshme, sepse më mirë janë tre muaj të institucioneve sesa shtatë muaj të Forumit të aftësive të kufizuara, është OJQ që nuk mund t'i mbikëqyrë realizimet e tyre, por edhe nëse i mbikëqyrë nuk do të ketë cilësi.

**Fatime Demolli - Mustafa** tha se Forumi vetëm u ka bërë kontratë pune, ndërsa mbikëqyrjen e ka Drejtoria komunale e Arsimit për rekrutimin e këtij personeli.

**Ramadan Salihu** shprehu mendimin se ne si Komitet duhet lobuar, ndoshta kurrë nuk bëhet, por duhet lobuar që kjo punë të bëhet në mënyrë institucionale.

**Mehreme Llumnica** u shpreh e pajtimit me z. Ramadanin, duke thënë se nëse nuk hyn në mënyrë institucionale, sa të duash dërgo projekte apo pilot-projekte që i ka bërë Forumi, ajo ka me qenë shumë afatshkurtër dhe nëse nuk ka përkrahje kanë me u tërhequr ata, sepse pa para nuk shkon askush.

Po ashtu, tha se te parkingu përveç shenjëzimit, mos të na ikën kjo çështja që e kanë kërkuar sikurse "Trafiku Urban", me qenë pa pagesë edhe për parkingjet.

**Jeton Canhasi** tha se sigurisht që Komuna ia cakton se ky është publiko-privat dhe nuk është vetëm Komuna, por edhe ata që po investojnë aty, me siguri me marrëveshje i lirojnë PAK nga pagesa, por ende është herët për këtë çështje.

**Mehreme Llumnica** theksoi se ne duhet shtuar këtë pikë, që atyre me iu rënë ndërmend me i ndarë ata që lirohen prej pagesës.

**Ramadan Salihu** lidhur me çështjen e punësimit, falënderoi "Trafikun Urban", të cilët në mënyrë më të mirë na kanë pritur, kanë shqyrtuar kërkesat tonë dhe në fund e kanë publikuar një konkurs.

### Pika e tretë

#### Gjendja nga COVID - 19 – testimi për PAK

**Mehreme Llumnica**, sa i përket gjendjes si pasojë e COVID- 19 te PAK, shtroi dilemën se sa po merren parasysh si palë me rrezik që përfshihen në kategorinë e të moshuarve, me sëmundje kronike etj., po ashtu sa është marrë iniciativë nga Drejtoria e Shëndetësisë për testimin e PAK. Ne kemi dërguar shumë ankesa dhe kërkesa të cilat nuk po realizohen, nuk po merren me prioritet. Në rast se arrijnë vaksinat sezonale, dyshoj se prapë nuk ka me u marrë parasysh kjo kategori.

**Premtime Preniqi** pyeti se kujt iu kanë drejtuar me kërkesë dhe a e kanë dërguar si listë.

**Mehreme Llumnica** u përgjigj, duke thënë se iu kanë drejtuare drejtpërdrejt Drejtorisë së Shëndetësisë dhe e kanë dërguar listën, por nuk janë përgjigjur fare. Ne e kemi thirrur në takim drejtorin por nuk është përgjigjur. Çdo organizate shëndetësore ose administrative në komunën e Prishtinës u është bërë testi në mënyrë të organizuar, e OJQ nuk qenka me prioritet, kur jemi kategoria më e ndjeshme me prioritet.

**Premtime Preniqi** theksoi se si Komitetit prapë dërgojeni një kërkesë në Drejtorinë e Shëndetësisë për t'i marrë me prioritet.

**Gyltene Retkoceri** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "Gjendja e PAK, gjendja psiko - fizike si pasojë e COVID- 19".

**Ramadan Salihu** u shpreh i pajtimit që të shtohet kjo pikë, por duhet me dhënë raport.

**Gyltene Retkoceri** theksoi se ne duhet përgatitur një raport, kështu qëndron gjendja, por a ka bërë diçka Komuna.

**Mehreme Llumnica** përkrahu mendimin e zotëri Ramadanit, të definohet angazhimi i një psikologu. Do të duhej shikuar se si ka vepruar Ministria e Shëndetësisë, sepse një kohë i ka angazhuar një grup psikologësh dhe kanë qenë vullnetarë.

**Gyltene Retkoceri** theksoi se atë e ka bërë Universiteti i Prishtinës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

**Fatime Demolli - Mustafa** pyeti se ku duhet drejtuar lidhur me këtë çështje.

**Gyltene Retkoceri** u përgjigj se ne për këtë çështje duhet drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

**Ramadan Salihu** bëri të ditur se drejtori i Shëndetësisë nuk iu ka përgjigjur në kërkesë për vaksinimin e PAK, sepse nuk ka kompetencën në këtë drejtim, kompetent është vetëm Institutit Kombëtar i Shëndetësisë.

**Fatime Demolli - Mustafa** theksoi se nëse shkojmë ne si Komitet me një kërkesë të tillë në Drejtorinë e Shëndetësisë, që jemi të interesuar ta bëjmë testimin për PAK, ne duhet të bazohemi në diçka, se a kanë kontakte, a kanë simptome, a kanë virus, sepse kjo nuk mund të bëhet vetëm pse po dëshirojmë një gjë të tillë.

**Premtime Preniqi** tha për ta futur në listë është në pyetje vaksina e gripit sezonal, dhe vaksina kur të vije me qenë prioritet, kështu që te Shëndetësia thekson që të jetë prioritet çështja e personave me aftësi të kufizuar, si te vaksina e gripit sezionale ashtu edhe te vaksina e COVID - 19.

**Mehreme Llumnica** bëri të ditur se ka kërkuar te Plani nacional i veprimit, me marrë iniciativë prej Ministrisë së Shëndetësisë, që kartelat shëndetësore kur është në gjendje në Shtëpi të Shëndetit me u zonuar me zona, është lehonë, është me diabet, është PAK etj., kur t'i vjen vaksina, shërbimet për personat me masa rreziku i kanë edhe ata.

**Premtime Preniqi** sugjeroi që te Shëndetësia me shtuar edhe kartelën shëndetësore, të identifikohet edhe lloji i aftësive të kufizuara.

**Ramadan Salihu** u shpreh se ne duhet konkret me ditur se çka po kërkojmë dhe me ia propozuar mënyrën si duhet me realizuar.

**Gyltene Retkoceri** tha se ndoshta duhet Komuna me bërë kërkesë për hapjen e një konkursi dhe me pranuar një numër të psikologëve, apo të stafit që ofron shërbime për këta persona, d.m.th. në kuadër të Komunës me ardhur me Hendikos.

**Premtime Preniqi** tha se nuk besoj që me konkurs mund të zgjidhet kjo çështje, më mirë kishte qenë me thënë me u bërë një marrëveshje me Fakultetin e Psikologjisë, për të pasur mundësi këta me bërë praktikën dhe, në anën tjetër edhe ju numërohet edhe si përvojë pune dhe këta psikologë me kryer këtë shërbim.

**Ramadan Salihu** u shpreh se kjo çështje duhet të realizohet me Shoqatën e Psikologëve, se aty duhet të ketë persona të licencuar, që kanë psiko-terapi, dhe a mundesh ti Gyltene me qenë bartëse e këtij projekti që me pasur aty njerëz të licencuar.

**Gyltene Retkoceri** tha studentët ndoshta e kryejnë punën, por ndryshe do ta kryente një profesionist me përvojë mbi 10 vjeçare.

**Premtime Preniqi** theksoi se kjo është një ide shumë e mirë me i punësuar psikologët e licencuar, mirëpo sa të nevojiten ty është shumë vështirë me i siguruar.

**Gyltene Retkoceri** tha neve së pari na duhet marrë një leje, ose një lloj bashkëpunimi ndërmjet Komunës që po u lejon Komuna studentëve të Psikologjisë me bërë punën praktike në Komunën e Prishtinës.

**Mehreme Llumnica** propozoi që të merret një shembull prej Ministrisë së Shëndetësisë se si e ka organizuar këtë çështje.

**Gyltene Retkoceri** bëri të ditur se është në mënyrë online, por kush ka probleme e thërret, është numri pa pagesë dhe i ke aty studentë, ke psikologë të diplomuar që dëshirojnë me dhënë kontributin e tyre.

**Fatime Demolli - Mustafa** potencoi se psikologët e shkollave tona gjatë kësaj pandemie kanë bërë jashtëzakonisht shumë, kanë dhënë kontribut si me fëmijët me nevoja të veçanta, ashtu edhe me fëmijët e rregullt në komunën e Prishtinës.

**Gyltene Retkoceri** shprehu mendimin se kjo nuk mund të realizohet pa mjete, por nëse ne kishim pasur mundësi me marrë mjete nga Komuna dhe me realizuar, do të ishte e mirëseardhur për këta persona dhe për Komunën e Prishtinës, nëse dëshirojmë me i dhënë prioritet kësaj qasje.

**Mehreme Llumnica** tha se duhet diskutuar me drejtorin e Shëndetësisë dhe drejtorin e Arsimit, që kur t'u ofrohen projekte, do t'u ofrohen edhe për çështje psikologjike, pse mos me marrë ndonjë donacion edhe për këtë çështje me marrë një iniciativë se kanë projekte.

**Premtime Preniqi** tha se ju jeni të organizatave dhe donatori që jep për këtë çështje, p.sh i ofrohesh Hendikosit, në bashkëpunim me Hendikosin aplikoni në organizatë për fëmijët e komunës së Prishtinës në përgjithësi për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara.

**Gyltene Retkoceri** u pajtua se kjo është ide e mirë. Ajo tha se unë punoj në një organizatë, kur kuptoj se ka thirrje të kësaj natyre, përpiloj një projektpropozim për aplikim për PAK për Komunën e Prishtinës. Nëse nuk e fitojmë, po presim kur t'i publikojë Komuna thirrjet, ne të shkojmë e të bisedojmë me drejtorin dhe ta informojmë se jemi prej Komitetit. Besoj se kjo do të ishte ide që mund të realizohet.

**Premtime Preniqi** problemi tjeter është se komiteti më shumë është konsultativ, d.m.th. këshilldhënës, me dhënë ide, si dhe e fundit ia dorëzoni, i shkruani të gjitha këto çështje dhe i ndani, ia dërgoni secilës drejtori që i përket, pra ky raport me u ndarë komplet.

**Mehreme Llumnica** tha se është e mirë me pasur ata një dokument, o patën kohë me trajtuar o nuk patën, një ide prej neve është mirë me ju përcjellë, se nesër nëse dëgjojmë një projekt e nuk është realizuar, ose nuk e kanë përdorur hiq, mund të thuash ja shkresën, nuk je marrë me të, kështu që kishte qenë mirë me kërkuar që me na pasur parasysh për ndonjë projekt i cili mund të na ofrohet.

**Fatime Demolli - Mustafa** u shpreh se raportin fillimi do ta diskutojmë me asamblistët e Komunës së Prishtinës, nëse na ftojnë në takim gjatë këtij muaji, pastaj të shohim për hapat e mëtejmë.

**Ramadan Salihu** pyeti znj. Mehreme se pensionet që u shpallën në atë grupin tonë, keni marrë pjesë edhe ju, a e keni sqaruar se a ndalet apo nuk ndalet pensioni, gjegjësisht a keni ndonjë rast konkret që iu ka ndalur pensioni ose nuk iu ka ndalur.

**Mehreme Llumnica** sqaroi, duke thënë se lidhur me këtë çështje ju është thënë nga Skënder Asllani se nuk ndalet pensioni. Edhe në Planin nacional, tash të riun, e ka cekur Ministria e Mirëqenies se nuk ndalet pensioni edhe me iu ofruar punësimi, vetëm me lajmëruar se është duke punuar, e ata atëherë e evidentojnë.

Sa i përket pyetjes se a ka rast konkrete që iu ka ndalur pensioni a jo, tha se ka rast konkret që nuk iu ka ndalur, p.sh. anëtarja jonë është duke punuar që katër vjet në Hendikos, në administratë, edhe nuk iu ka ndalur pensioni, e kemi lajmëruar dhe na e kanë kthyer e-mailin se nuk iu ndalet.

**Ramadan Salihu** theksoi se i vijon trusti pensional, e paguan dhe nuk i ndalet.

**Mehreme Llumnica** tha se e paguan dhe nuk i ndalet.

Premtime Preniqi theksoi se d.m.th. që e merr rrogën dhe pensionin.

Mehreme Llumnica bëri të ditur se te ligji i të verbërve dhe ligji i paraplegjikëve nuk ju ndalet, te ta është e rregulluar edhe me ligj.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:45.*

Procesmbajtësja:  
Shyrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli - Mustafa

